



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 26

Prishtinë, më 10.10.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Liburn Aliu, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Ministri dhe zyrtar nga Ministria e MMPH, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), përfaqësuesi i Bordit të Mjedisit, Ombudspersonit, media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 3.10.2011,**
3. **Shqyrtimi i çështjeve mjedisore me ministrin Dardan Gashi,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.10.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 3.10.2011.

3. Shqyrtimi i nivelit të zbatimit të ligjeve mjedisore dhe VNM si dhe funksionimit të Bordit mjedisor, me ministrin e MMPH

Kryetari Nait Hasani dëshiroj mirëseardhje ministrit dhe kaloi fillimisht në çështjen e zbatimit të ligjit për VNM i cili ligj në teren shkakton shqetësime serioze për shkak të degradimit të mjedisit duke nisur nga gurthyes të ndryshëm e deri te dëmet tjera mjedisore që dëmtojnë rëndë jetën e njeriut. Ai sugjeroi që ministria të bashkëpunoi me komisionin (sidomos pas monitorimit të Ligjit për VNM nga grupi punues) dhe të shqyrtohet mundësia e zgjidhjeve të problemeve në teren përkatësisht që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji.

Ministri Dardan Gashi konstatoi se ky ligj në teren më së shumti është keqkuptua dhe është keqpërdor ngase pëlqimi mjedisor nuk është leje mjedisore. Zyrtari i departamentit përkatës i MMPH në vazhdim sqaroi më hollësisht dhe tha se ministria ka bërë plane më rigorozë sa i përket zbatimit të këtij ligji në mënyrë që në fazën finale të përgatitet një vendim në nivelin qendror për çështjet kryesore në këtë fushë. Në bazë të ligjit në fuqi për VNM, raporti për VNM është instrument preventiv për mbrojtjen e mjedisit, ndërsa pas vitit 2009 janë pranua 183 aplikacione në ministri, çka flet se projektuesit tani janë vetëdijesuar sa i përket projekteve sa më reale.

Nait Hasani falënderoi për sqarime fillestare dhe vazhdoi me disa pyetje siç është mjedisi në Radavc, Obiliq, Llukovc, prishje të lumenjve, Shpellën e Mermerit etj me pyetjen konkrete çka ka stopuar MMPH deri tani sa i përket dëmeve në mjedis.

Dardan Gashi mori shembull shpellën e Gadimes për të cilin është kërkuar nga MEF të epet në koncesion pasi që nuk është pronë private, ndërsa **Arben Çitaku** tha se gurthyesit në periferi të shpellës kanë marr pëlqime mjedisore mirëpo janë stopuar me kërkesën e inspektorëve të cilët kanë kërkuar tërheqjen e pëlqimeve, mirëpo komunikimi me operatorë ekonomik është e vështirë dhe ata vazhdojnë punën. Pikërisht për shkak të operatorëve të pandërgjegjshëm Ministria ka ngrit padi në rastin e Sharrcem-it dhe Feroniklit për të vetëdijesuar palët, por kaq është mundësia e ministrisë me masa administrative. Masat gjyqësore sipas iniciativave të kësaj ministrie fatkeqësisht nuk kanë sukses përveç disa përpjekjeve të cilat në kohën e fundit kanë fillua të shpeshtohen nga Gjykatat. Nga zyrtarët prezent u theksuan disa shembuj me deponi (në Landovicë) etj, për të cilat MMPH ka autorizim me i mbyllë, por rihapja diku tjetër kushton mjaft, për çka nuk ka buxhet. Sipas pyetjes së **Nait Hasanit** rreth deponis së Dragashit në Zhur, zyrtarët e ministrisë thanë se ajo është lejuar nga kryetari i komunës për çka ai edhe duhet të mbaj përgjegjësinë. Për këtë arsye ministria ka kërkuar nga të gjitha komunat të mos tejkalojnë kompetencat e tyre ngase me leje arbitrare vetëm sa keqësojnë gjendjen edhe ashtu alarmante.

Liburn Aliu tha dhe konstatoi se fillimisht shkon pëlqimi pastaj leja mjedisore, atëherë pse nuk ndalen punët, a do të thotë kjo se të gjitha punët zhvillohen “në të zezën”, ose fajin e mban komuna. Për autostradën pyeti a e ka lejen mjedisore. **Arben Çitaku** u përgjigj se leja epet më vonë, deri tani asnjë leje nuk është lëshuar ngase duhet të shikohet a plotësohen kushtet (reagoi Liburn Aliu me pyetjen pse shumica lëshohen në punë konkrete), në këtë drejtim (Muhamet Malësiu) ministria zbaton edhe direktivat e BE ku në ca raste kërkohen lejet integruese mjedisore për të cilat nevojitet një kohë më e gjatë për shkak se aty kërkohet shkalla e ndotjes, nëse nuk ndalohen ato veprime dëmtuese mjedisore, pastaj pason ndalimi i veprimtarisë së caktuar. Për këto çështje serioze, ata theksuan se ministria ende nuk ka staf adekuat. **Liburn Aliu** sqaroi se komisioni përafërsisht i ka të qarta këto çështje dhe pikërisht për këtë diku kah muaji maj i këtij viti ka kërkuar veprime konkrete nga kjo ministri, por kot, ndaj tani është formuar grupi punues për monitorimin e Ligjit për VNM. Ai shtoi se nuk bënë gjithmonë të shfajësohemi duke përmend ish shtetin e Jugosllavisë (Serbinë) ngase edhe ne pas luftës kemi kontribua sidomos në degradimin e brigjeve të lumenjve (Drini etj). Z. Malsiu tha se rezultatet konkrete të ministrisë mund të shihen në shembullin me KEK ku është tani gjendja shumë ma mirë dhe kjo do të vazhdoi. **Daut Haradinaj** u interesua për rajonin e Trepçës ku kalojnë materialet e rrezikshme por edhe tek Drini i Bardhë ku madje është larguar edhe policia, pastaj pyeti ku është dallimi midis lejes për hulumtim dhe lejes për shfrytëzim ngase prej 172 lejeve për hulumtime sa ka identifikua ai, padyshim se bjeshkët tona do të asgjësohen ngadalë, ai sugjeroi që këto leje apo

pëlqime të ndalohen. Ai pastaj vazhdoi “ju ministria duhet ose të merrni përsipër të shërbeni rreth brigjeve të lumenjve, ose deponive etj ngase përndryshe krimet veç kanë marr karakter të krimet të organizuar”. Potenco i edhe rastin e Rahovecit ku asgjë nuk mund të bëhet në aspektin e mbeturinave, për shkak të çështjes së regjionalizimit. Ministri fillimisht tha se lejet hulumtuese janë ndaluar si dhe konstatoi se nuk ka pengesë për mbledhje private të mbeturinave, përndryshe ministria është në aksion me komunat për përpilimin e strategjisë së përbashkët rreth mbeturinave ndërsa Sekretari i MMPH sqaroi se komisioni për miniera e minerale fillimisht shqyrton kërkesën pastaj ministria e mjedisit jep pëlqimin, çka nuk do të thotë se bëhet fjalë për licencë. Për autostradë tha se VSM-në e ka kryer një kompani Daneze (Cowi) mirëpo **Liburn Aliu** u interesua cili është personi i tretë në këtë rast i cili bënë vlerësimin ngase nuk mund të kryhet një punë vetëm midis Qeverisë dhe kontraktorit.

Nait Hasani tha se mbledhja e sotme është vetëm fillimi i mbikëqyrjes së VNM, ndaj ndërpreu diskutimin e mëtejme rreth detaleve duke konstatuar se këto çështje do të mbikëqyren segment pas segmenti.

Sevdije Lama pyeti për kompetencat e ministrisë rreth çështjes së rrëshqitjeve të dheut sa kanë qasje në to, sidomos në Gjakovë. Ministri tha se ministria në këto raste reagon aq sa mundet, përndryshe komunat kanë obligimet e tyre në kuadër të përgjegjësisë së tyre.

Nijazi Idrizi konstatoi se grupi punues rreth monitorimit të Tokës Bujqësore ka konstatua një gjendje ndryshe nga ajo si është gjendja në të shkruar dhe me ligje, p.sh. është thënë se brenda 24 km ekzistojnë 24 operatorë ekonomik, çka komisioni nuk din se ky fakt është apo nuk është e saktë. Pastaj çështja e pëlqimeve nga MMPH në terren në shumicën e komunave i emërtonin si leje, ai kërkoi sqarime më të hollësishme nga ministria rreth pëlqimeve dhe lejeve. Ministri tha se ministria me komuna ka pasur edhe dëgjim publik ku janë përgjigjur shumë pak inspektorët komunal, mirëpo Nijazi Idrizi konstatoi se ministria është ajo që duhet të insistoi në zbatimin e ligjit. Ai gjithashtu kërkoi sqarime rreth tokës së ndotur ngase analizat që janë shkua disa në Gjermani a janë reale apo duhet të bëhen superanaliza. Për çështjen e lumenjve që po vdesin potencoj rastin në Shkabaj (hiri) që pengon ujitjen e 600 ha tokë, duke pyetur sa ka njohuri ministria. Ministri tha se tjera herë duhet më herët të dërgohen pyetjet, ngase sot p.sh. nuk është i përgatitur për të përgjigjur në këtë pyetje, për çka u pajtua edhe kryetari duke kërkuar që në këto pyetje ministria të përgjigjet me anë të raportit të veçantë në fund të këtij monitorimi.

Në vazhdim **Kryetari Nait Hasani** kaloi në çështjen e funksionimit të Bordit Mjedisor, për të cilin komisioni është interesuar pse nuk funksionon. Ai sqaroi datat e rëndësishme lidhur me Bordin e Mjedisit, sidomos datën 12.10.2010 kur ish komisioni parlamentar për bujqësi dhe mjedis ka kërkuar (sipas pikës 3 të përfundimit) nga kjo ministri edhe zgjidhjen e çështjes financiare për këtë bord në mënyrë që të funksionoj në mënyrë të rregullt.

Ministri Gashi tha se menjëherë më 3.12.2010 ministria është drejtuar komisionit kompetent me kërkesë ku është kërkuar 96.550,00 euro për Bordin ndërsa në aspektin teknik është siguruar një zyre me pajisje të nevojshme për funksionalizim të Bordit, ku më tutje për shkak të mungesës së buxhetit, kërkesa është përcjellë Qeverisë dhe Kuvendit në vendosje të mëtejme. Ai tha se këtë shkresë-kërkesë mund ta përsërisin prapë pasi që është i kohës kur ka përfunduar legjislacioni i tretë (sekretari i MMPH ja dorëzoi kryetarit të komisionit), mirëpo potenco i se kjo kërkesë duhet me pas rekomandimin adekuat nga Komisioni parlamentar për Buxhet dhe Financa pasi që secili rregullor i cili shoqërohet me deklaratën financiare nga MEF duhet të përcjellët me rekomandimin e komisionit për buxhet. Nëse lejon ky komision, ministria pastaj mund të veproji sipas parashikimit të kërkesës së cekur më lart.

Sylejman Berisha nga Bordi i mjedisit vërtetoi faktin se në cilësinë e kryesuesit gjithashtu ka njoftuar kompetentët për çështje buxhetore duke kërkuar zgjidhje ligjore.

Kryetari Nait Hasani me pajtimin e komisionit nxori këtë :

P Ë R F U N D I M

1. Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis do të parashtroi kërkesë për zyrtarët e Kuvendit lidhur me funksionimin e Bordit të Mjedisit duke sugjeruar propozimet e cekura nga MMPH.
2. Komisioni do të jap mbështetjen financiare për MMPH dhe MBPZHR lidhur me çështjet mjedisore dhe bujqësore, në mënyrë që të ritet buxheti i ministrisë për vitin e ardhshëm.

4. Të ndryshme

I. Në këtë pikë komisioni shqyrtoi dhe vendosi si vijon :

Nga Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës të kërkohet si vijon : 1. Të shqyrtohet çështja e imunitetit të deputetëve të Kuvendit të Kosovës me çka Kushtetuta do të përkufizoj qartë të drejtat e deputetëve dhe imunitetit të tyre. 2. Rishikimi i kapitullit III sa i përket të drejtave të komuniteteve, sidomos i privilegjeve sipas Nenit 64, me të cilin nën komuniteteve ju garantohen 20 vende për përfaqësim në Kuvendin e Kosovës, dhe 2. FSK të shndërrohet në Ushtrinë e Kosovës.

II. Bashkëngjitet komisioni në vizitë për Shqipëri rreth trajnimeve për Planin për veprim për Mjedis me Qendrën rajonale për mjedis-REC e cila mbështet financiarisht këto vizita, nga data 12-15 tetor, 16-19 tetor dhe 19-22 tetor nga dy deputet. Nëse nuk shkojnë dy deputet në çdo vizitë, do të shkon stafi i komisionit, nga një në çdo vizitë.

III. Rekomandimet rreth mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Tokën Bujqësore do të hartohen më 26 dhe 27 tetor 2011 në vendin ku do të sugjerohet nga mbështetësi i OSBE.

IV. Më 17.10.2011 mbahet mbledhja e komisionit ku do të shqyrtohet projektligji për Shitjen e Banesave.

V. Komisioni konstatoi se rekomandimet e këtij komisioni për projektligjin për Prodhimin e Duhanit janë shqyrtuar nga Komisionet e përhershme, ndërkaq rreth vërejtjes së Komisionit për legjislacion për Amendamentin 1 të projektligjit për Prodhimin e Duhanit, u pajtua që në fund të këtij amendamenti të shtohen fjalët “**dhe llojet e tjera**”, më tutje të dërgohet rekomandimi i komisionit në leximin e dytë.

Mbledhja përfundoi në orën 12,20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani